

PARTNERITETI PER QEVERISJE TE HAPUR (OGP)

**PLANI KOMBETAR OGP PER SHQIPERINE 2022-
2024/NATIONAL ACTION PLAN FOR ALBANIA**

2022 – 2024

**RAPORTI NE KUADER TE PROCESIT TE FAZES SE
TRETE TE HARTIMIT TE PLANIT OGP 2022-2024**

**FEEDBACK REPORT PER FAZEN E III-TE TE HARTIMIT
TE PLANIT OGP 2022-2024**

13.02.2023 – 06.03.2023¹



¹ Në përputhje me shkresën MSHSSH Nr.6493.Prot, date 22.11.2022 dhe Planit të Punes të dorëzuar me shkresë si dhe publikuar në faqen ogp.gov.al

Procesi i hartimit të Planit Kombëtar OGP 2022-2024 i ndjekur nga institucionet ne perputhje me shkresen e MSHSSH Nr.6493.Prot, date 22.11.2022 me lende “Mbi procesin e hartimit te PKV OGP 2022-2024”²

Ministria e Drejtësisë

Agjencia per mbeshtetjen e shoqerise civile

1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit.
2. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi.

CONSULTATION 3

Consultation Details

Policy Goal Focus	Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e Aksesit në Drejtësi dhe Luftën Kundër Korrupsionit.
Lead Focal Point Institution	<ul style="list-style-type: none">• Znj. Elona Hoxha - Drejtor Drejtorie, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë.• Znj. Rovena Prega - Drejtor Drejtorie, Drejtoria e Programeve dhe Projekteve Antikorrupsion.
Date	21.02.2023
Consultation Meeting Number	3

I. Objective of Consultation Meeting

What was the aim of this consultation? Please answer for all that apply	Details: Në kuadër të inicimit të hartimit të planit të ri të
--	---

² Procesi i identifikimit te prioriteteve eshte kryer ne perputhje me standartet OGP ne kuader te procesit te bashkeberjes. Te gjitha evidenacat do te paraqiten tek anetaret e Komitetit OGP si dhe ne publikohen ne faqen ogp.gov.al

	<p>veprimet për OGP 2022 – 2024, u zhvillua takimi i tretë konsultativ që korrespondon me fazën e tretë të procesit, atë të hartimit të planit të veprimit, të masave dhe aktiviteteve dhe të produkteve të këtij plani, në bashkëpunim me OSHC dhe grupe të tjera të interesit.</p> <p>Në takim morën pjesë përfaqësues të shoqërisë civile, të ministrive të linjës si dhe të institucioneve në varësi të MD.</p> <p>Ministria e Drejtësisë, prezantoi dy angazhimet prioritare të “Aksesit në Drejtësi” dhe “Luftës kundër Korrupsionit”, të miratuar nga Komiteti Shumëpalësh i OGP dhe që do të udhëhiqen gjatë zbatimit nga MD.</p> <p>Në takim u njoftua nga MD edhe formati i PV. Drejtoritë e MD paraqitën planin e masave të tyre, dhe kohën e zbatimit, dhe kërkuan nga OSHC dërgimin e propozimeve të tyre si dhe u njoftuan mënyrat e komunikimit në vijim me palët.</p> <p>MD njoftoi gjithashtu edhe datën e zhvillimit të takimit të dytë konsultativ të kësaj faze, për në datë 24.2.2023.</p>
(i) Introduce stakeholders to the proposed policy goal	<p><input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes</p> <p>Ministria e Drejtësisë në kuadër të detyrimeve që burojnë nga anëtarësimi i Shqipërisë në Partneritetin për Qeverisjen e Hapur (këtu e tutje “PQH” ose “OGP”), nisur fusha e saj e përgjegjësisë ka propozuar angazhime për fushën si më poshtë:</p> <p>Aksesi në drejtësi, shihet si një nga komponentët kyç të qeverisë shqiptare e ndërlidhur fort me zbatimin e reformës në drejtësi, Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND 2021-2025), Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur (SNDM 2022-2026), Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP 2019-2023), si dhe masat e tjera të ndërmarra nga Qeveria në përmbushje të misionit të saj për një qeverisje të hapur, transparente dhe llogaridhënëse.</p>

Të gjitha propozimet për masa dhe aktivitete të vendosura nga MD dhe ato të marra nga OSHC e fushës të marra në këtë takim u bënë pjesë e draftit të planit të veprimit. Gjatë takimit pati pjesëmarrës të tjerë të interesuar të cilët shprehën komente dhe sugjerime/ide mbi angazhimin e propozuara nga MD.

Aksesi në Drejtësi, në vijim dhe të takimeve të mëparshme të realizuara, u propozuan dy objektiva specifike për këtë komponent;

Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi:

2.1. Ndërgjegjësimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi.

2.2. Edukimi i Publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi.

Ndaj dhe masat lidhur me aksesin në drejtësi, propozohen nga këto fusha të cilët synojnë ndërgjegjësimin dhe edukim të publikut mbi aksesin në drejtësi.

Ndaj për këtë qëllim, MD rikërkoj bashkëpunimin me OSHC, për realizimin e masave konkrete në fushën e aksesit në drejtësi, në kuadër të hartimit të Planit të Veprimit për Qeverisjen e Hapur (2022)2023– 2024.

Lufta kundër korrupsionit, është një ndër politikat më prioritare, të cilat vendi ynë këshillohet t'i ndjekë me përparësi. Parandalimi, ndëshkimi dhe ndërgjegjësimi i publikut lidhur me luftën Kundër korrupsionit është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentat ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO), Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit etj.

Në vijim dhe të takimeve të mëparshme të realizuara, u propozuan nga MD dy objektiva specifike për këtë komponent;

1.1. Ndërgjegjësimi i publikut të gjerë mbi

	<p>mekanizmat në luftën kundër korrupsionit.</p> <p>1.2. Edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit.</p> <p>MD bëri të njohur propozimet e saj për masa dhe aktivitet në dokumentin PPT të paraqitur, dhe komentoj domosdoshmërinë e tyre në përmbajtje të PV.</p> <p>Masat janë në harmonizim me dokumentet e politikave dhe ato të veprimit që hartn dhe ndjek MD me Drejtorinë Antikorrupsion.</p>
<p>(ii) Introduce stakeholders to the OGP process</p>	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Po. Në Takimin e tretë Konsultativ, i cili u mbajtonline në Platformën Microsoft Teams, ku u ftuan rreth 70 përfaqësues, pjesëmarrës të ministrive të linjës, të organizatave të shoqërisë civile, botës akademike dhe aktorë të tjerë të interesuar, të cilëve iu dha mundësia të ofrojnë opinionet dhe sugjerimet e tyre, lidhur mbi propozimin e masave/produkteve konkrete lidhur me komponentin e aksesit në drejtësi dhe luftës kundër korrupsionit, si komponentët kyç të qeverisë shqiptare të ndërlidhura fort me zbatimin e reformës në drejtësi dhe politikat antikorrupsion.</p> <p>Në prezantimin e ofruar <i>ppt</i>, u pasqyruan angazhimet prioritare finale të Ministrisë së Drejtësisë për dy komponentë të ndarë në “Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit” si pjesë e fushës së Parë të OGP - “Antikorrupsioni & Integriteti dhe pronarët përfitues” dhe “Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi” pjesë e fushës së Dytë – Aksesit në Drejtësi”.</p> <p>MD gjithashtu prezantoi edhe formatin përfundimtar që do të ketë dokumenti i planit të veprimit si edhe ecurinë e procesit dhe konsultimin e tij në vijim.</p>
<p>(iii) Explain the feedback tools for stakeholders</p>	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Në Takimin e tretë Konsultativ, i mbajtur online në platformën Microsoft Teams, u realizua një panoramë</p>

	<p>e gjerë e metodologjisë dhe e rëndësisë së procesit i cili për shkak të natyrës ka afate shumë të ngushta për finalizimin e planit të ri të veprimit.</p> <p>Në prezantimin me <i>PPT</i> u pasqyruan angazhimet prioritare të Ministrisë së Drejtësisë mbi dy komponentë të ndarë si “Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit” dhe “Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi”.</p> <p>Në vijim znj. Hoxha dhe znj. Pregja prezantuan objektivat specifike dhe masat/produketet për aksesin në drejtësi dhe të luftës kundër korrupsionit.</p> <p>Të dy komponentët e Ministrisë së Drejtësisë janë paraqitur sipas OGP-së të ndara në dy prej fushave të saj ku “Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit” do jetë pjesë e Fushës së Parë të OGP - “Antikorrupsioni & Integriteti dhe pronarët përfitues” dhe “Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi” pjesë e Fushës së Dytë – Aksesit në Drejtësi”.</p> <p>Gjatë takimit të zhvilluar, OSHC dhe aktorët e tjerë pjesëmarrës, komentuan dhe shprehën gadishmërinë për të dërguar kontributet e tyre nëpërmjet e-mailit për komponentët e MD-së.</p> <p>Në fund të takimit konsultativ, pjesëmarrësve iu bë me dije që të ndiqnin faqen e OGP Albania në linkun https://ogp.gov.al/faqe/procesi-i-bashke-krijimit si dhe u rikujtuan për takimin e rradhës i cili do mbahet ditën e premte datë 24.02.2023, në platformën Teams si edhe kërkesën për ti sjellë paraprakisht në emailin e MD propozimet e tyre dhe për ti paraqitur në takimin e ardhshëm.</p>
(iv) Brainstorm ideas with stakeholders	<p><input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes</p> <p>Takimi i konsultimit pati komente dhe dakordësi për çështjet e diskutuara dhe gadishmëri për të përfshirë</p>

	<p>masa dhe aktivitete që zhvillohen apo do të zhvillohen nga OSHC.</p> <p>Dy prej OSHC, IDM dhe KSHH ndërhyjnë me propozime konkrete, gjithashtu.</p>
(v) Develop further details (milestones, etc.) for ideas	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Masa prioritare e lidhur me fushën e antikorrupsionit, pati një propozim konkret për tu zhvilluar edhe një masë e tretë e lidhur me përfshirjen direkte të administratës publike, si përfituese por edhe zbatuese e angazhimeve të ardhura direkt nga OSHC.</p> <p>Ky propozim erdhi nga IDM.</p>
(vi) Gather feedback on proposed policy goals	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Takimi i tretë konsultativ, u realizua prezantimi me PPT, duke parashtruar draftin e objektivave specifik dhe masave/produkteve konkrete për sa i përket komponentit të Aksesit në Drejtësi dhe Luftës kundër Korrupsionit, të cilët lidhen me ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut të gjerë mbi këto mekanizma, të sjella si propozime të MD.</p>
(vii) Prioritize proposed policy goals	<input checked="" type="checkbox"/> No / <input type="checkbox"/> Yes
(viii) Other (provide details)	<input checked="" type="checkbox"/> No / <input type="checkbox"/> Yes
II. Methodology	
<p>What was the format of the meeting?</p> <p>How were stakeholders able to participate?</p>	<p>Takimi i tretë konsultativ u organizua online, nëpërmjet Platformës Microsoft Teams. Natyra e takimit ishte e hapur, interaktive dhe frytdhënëse.</p> <p>Link i takimit është: Microsoft Teams meeting</p>

	<p>Meeting ID: 326 362 337 121</p> <p>Passcode: WgW9MS</p> <p>Pjesëmarrësit nuk patën vështirësi në ndjekje të takimit.</p>
(i) Presentations	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Angazhimet prioritare të MD-së; ✓ Prezantimi i Draft Planit të Veprimit 2022 – 2024; ✓ Prezantimi objektivave specifik për tëdy komponentët e Ministrisë së Drejtësisë; ✓ Prezantimi i draft masave/produkteve paraprake për Planin e Veprimit 2022 – 2024 mbi komponentin e aksesit në drejtësi dhe të luftës kundër korrupsionit. ✓ Si do të vijojë procesi? ✓ Takimi i ardhshëm i konsultimit.
(ii) Discussion / Feedback from stakeholders	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Gjatë takimit u dakordësua që aktorët pjesëmarrës të dërgojnëelektronikisht në adresat e kontaktit, masat/produktet konkrete të cilat do tëpropozohen prej tyre për periudhën 2022 – 2024, për të dy komponentët e Ministrisë së Drejtësisë, të Planit të Veprimit OGP.</p> <p>Organizatrat si IDM dhe KSHH i paraqiten edhe në takim direkt, gjithashtu.</p>
(iii) Questions and answers	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Pjesëmarrësve iu dha mundësia për të bërë pyetje dhe për të diskutuar. Në përgjithësi pati dakordësi lidhur me angazhimet e propozuara dhe konstatime pozitive.</p>
(iv) Brainstorming	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Pjesëmarrësve iu dha mundësia për të bërë pyetje dhe diskutuar mbi draftin paraprak.</p>

Stakeholder Selection	Details
(i) How were stakeholders selected?	<p>Ministria e Drejtësisë, për shkak të funksionit të saj dhe bashkëpunimit me organizatat si dhe shumë projekte të ndërmarra në fushën e drejtësisë dhe të fushës antikorrupsion ka përfshirë mjaftueshëm organizata të shoqërisë civile, qendrave studimore, akademisë dhe juristëve të shquar. Si rrjedhojë, për këtë proces është si për projektet e tjeranë në fushën e drejtësisë, u përdor lista e shoqërive civile/grupeve të interesit të cilat kanë lidhje direkte ose indirekte me aksesin në drejtësi, transparencën, llogaridhënien institucionale, integritetin, konsultimin publik, antikorrupsionin. Për shembull, lista e grupeve të interesit, përfshin: shoqatat civile që kanë lidhje direkte me sistemin e drejtësisë dhe prekin tema të ndryshme sociale-ekonomike si, ndihma ligjore për gratë dhe fëmijë, grupet e vulnerabël, ndihma ligjore për rastet e dhunës në familje, shoqatat në ndihmë të minoritetëve dhe emigrantëve.</p> <p>Gjithashtu, janë përfshirë fakultetet e drejtësisë së universiteteve shtetërore dhe private si dhe akademike/profesorë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre me lidhje direkte në sistemin ligjor si dhe qendra studimore dhe shoqata që merren me vëzhgimin e veprimtarisë së institucioneve shtetërore me synim kërkim dhe llogaridhënies nga ana e qeverisë.</p> <p>Organizatë të specializuara dhe fokusuar në projekte bashkëpunimi me politikën dhe nismat antikorrupsion.</p> <p>MD aplikoi edhe njoftimin e hapur për pjesëmarrje në rrjetet e saj sociale të komunikimit dhe të interesuar që e morrën njoftimin në këtë mënyrë iu bashkuan takimit.</p>
(ii) How were stakeholders contacted?	Palët e interesuara u ftuan të ishin pjesë e këtij

	<p>procesi në rrugë elektronike/telefon. Ftesa u shoqërua edhe me agjendën e takimit.</p> <p>MD nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion aplikoi edhe njoftimet për pjesëmarrje në rrjetet sociale të komunikimit si facebook, linkedIn dhe twitter.</p> <p>Shik për më shumë profilet e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit.</p>
(iii) How many stakeholders were contacted?	(Rreth) 70
(iv) Was the consultation announced publically? (via websites, social media, etc.)	Po.Njoftimi është kryer në rrugë elektronike/via-email, telefon, rrjete sociale të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, me poster të dedikuar për pjesëmarrje.
(v) Were stakeholders reminded?	Po. Palët e interesuara dhe të ftuara në këtë proces janë rikujtuar në rrugë elektronike/ via- email/Telefon rrjete sociale të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, me poster të dedikuar për pjesëmarrje. Data: 23.02.2023
III. Results/ Findings	
Stakeholder Contributions	Details
(i) How many stakeholders attended?	18pjesëmarrës
(ii) Did stakeholders contribute?	Po
(iii) Main issues identified by stakeholders	Takimi ishte konsultativ dhe i frutshëm dhe gjatë takimit nga palët prezente u dhanë disa sugjerime/ide/komente.
(iv) Main recommendations from stakeholders?	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërgjegjësimi i qytetarëve mbi aksesin në drejtësi; • Shtimi i një mase prioritare të re e cila lidhet me edukimin e administratës publike në lidhje me çështjet e antikorrupsionit; • Krijimi i një instrumenti për monitorimin e institucioneve që kanë plane integriteti;

	<ul style="list-style-type: none"> • Informimi i qytetarëve mbi këtë mekanizëm, për akses dhe rrugët e ndjekjes; • Informimi i qytetarëve dhe i organizatave të shoqërisë civile kryesisht mbi korrupsionin dhe mekanizmat për luftimin e korrupsionit; • Shtimi i një mase prioritare si edukimi dhe ndërgjegjësimi i administratës publike për antikorrupsionin; • Vendosja e aktiviteteve dhe produkteve konkrete të OSHC, për vitet e zbatimit të PV, për angazhimin e antikorrupsionit; • Bashkëpunim i vazhdueshëm me DNJF, të nevojshëm që qytetarët të ndërgjegjësohen dhe të njihen më tepër me konceptin e mekanizmave të aksesimit të drejtësisë.
--	---

IV. Shortcomings Identified & Preparations for Next Consultation

	Details
(i) Limitations in stakeholder attendance	Jo. U ftuan rreth 70 përfaqësues institucionesh, OSHC, akademia, ministritë e linjës, në rrugë elektronike (email) por edhe me thirrje të hapur (facebook/linkedin, twitter).
(ii) Limitations in stakeholder participation	Jo.
(iii) What can be done to improve attendance?	Promovimi i faqes së OGP Albania për çdo informacion shtesë gjatë procesit.
(iv) What can be done to improve participation in the next meeting?	<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i një ure të përbashkët midis aktorëve të interesuar dhe Ministrisë së Drejtësisë do të ndikojë në ofrimin e propozimeve dhe kontributeve për të përmirësuar secilin nga fushat përkatëse gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre; • Inkurajim duke biseduar drejtpërdrejt me palët e interesit për rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre; • Kërkesë direkte për miratim drafti.

Stakeholder Feedback

Name:	Znj. Servete Ceka	Organization/ Affiliation:	Komiteti Shqiptar i Helsinki	Position:	Menaxhere projekti
--------------	-------------------	---------------------------------------	---------------------------------	------------------	--------------------

Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas

Comments:

- Realizimi i një sërë aktiviteteve ndërgjegjëse në terren ku fokus ka qenë informimi i qytetarëve dhe i organizatave të shoqërisë civile kryesisht mbi korrupsionin dhe mekanizmat për luftimin e korrupsionit,
- Ndërgjegjësimi i qytetarëve mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi;
- Bashkëpunim me drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, e nevojshme që shoqëria civile dhe qytetarët të fokusohen në të.
- Fokus i shtuar për ndërgjegjësimin dhe informimin e qytetarëve mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi.

Issues Raised

Feedback:

- Është e rëndësishme ndërgjegjësimi dhe informimi i shtuar i qytetarëve për mekanizmat e aksesit në drejtësi.
- Rëndësia e bashkëpunimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me KSHH si dhe me OSHC të cilat kanë fokus mekanizmat e aksesit në drejtësi.

Name:	Znj. Rovena Sulstarova	Organization/ Affiliation:	IDM	Position:	Menaxhere projekti
--------------	---------------------------	---------------------------------------	-----	------------------	--------------------

Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas

Comments:

Përveç dy objektivave specifik të edukimit dhe ndërgjegjësimit, sugjeron dhe shtimin e një mase prioritare të re e cila lidhet me edukimin dhe ndërgjegjësimin e administratës publike në çështje të integritetit, konsultimit, kapaciteteve monitoruese si instrumente AK, duke qenë se IDM ka punuar fort me planet e integritetit të cilat janë instrumente që i përkasin institucioneve publike.

IDM ka si synim që të punojë në këtë fushë, me plane integriteti dhe me Kode Etike për institucionet publike.

Edukimin e administratës publike aktualisht po zbatojnë një projekt në lidhje me njoftimin e koordinatorëve të konsultimit publik në lidhje me manualin për detajimin e kësaj procedure, aktivitete që presim t'i zhvillojmë në pjesën e parë të këtij viti.

Ndërgjegjësimin qytetar është në fazë të zhvillimi të një projekti për krijimin e një instrumenti për monitorimin e institucioneve që kanë plane integriteti, të cilat duhet të shihen dhe në hartimin e planit të veprimit.

Issues Raised

Administrata publike të ketë masë të posacme prioritare dhe angazhimi në planin e veprimit.

Feedback:

Të gjitha sugjerimet të bërangea IDM (*Institute for Democracy and Mediation*) do merren në konsideratë, përfshirë këtu edhe shtimin e një objekti specifik për edukimin në administratën publike në komponentin e luftës kundër korrupsionit.

Në draftin e rishikuar do të përfshihen propozimet e marra prej tyre.

CONSULTATION 4

Consultation Details

Policy Goal Focus	Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e Aksesit në Drejtësi dhe Luftën Kundër Korrupsionit.
Lead Focal Point Institution	<ul style="list-style-type: none">• Znj. Elona Hoxha - Drejtor Drejtorie, Drejtorja e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë.• Znj. Rovena Preqja - Drejtor Drejtorie, Drejtorja e Programeve dhe Projekteve Antikorrupsion.
Date	24.02.2023
Consultation Meeting Number	4

V. Objective of Consultation Meeting

What was the aim of this consultation?
Please answer for all that apply

Details:

Në kuadër të hartimit të planit të ri të veprimit për OGP 2022 – 2024, u zhvillua takimi i katërt konsultativ që korrespondon me fazën e tretë të procesit, atë të hartimit të planit të veprimit, tëkonceptimit dhe planifikimit tëmasave dhe aktiviteteve e të produkteve të këtij plani, në bashkëpunim me OSHC dhe grupe të tjera interesi.

Në takim morën pjesë përfaqësues të shoqërisë civile, të ministrive të linjës si dhe të institucioneve në varësi të MD, në cilësinë e propozuezeve të masave por edhe të rolit zbatues të tyre.

Ministria e Drejtësisë, për angazhimet prioritare të “Aksesit në Drejtësi” dhe “Luftës kundër Korrupsionit”, prezantoi një draft plani veprimi me masat dhe aktivitetet bazë (*milestone*) dhe produktet konkrete të pritshme, të punuar në formatin respektiv të OGP.

Draft plani i veprimit i propozuar vetëm me masatëu prezantua gjerësisht në takim, sipas formatit tip të planit të veprimit, për të gjitha rubrikat e tij, roli i institucioneve të përfshira, afati i zbatimit.

Qëllimi i zhvillimit të takimit ishte dakordësimi i masave të parashikuara në planin kombëtar të veprimit për qeverisje të hapur 2022 – 2024, me të gjithë grupet e interesit, dhe për të cilën u dha miratimi.

(ix) Introduce stakeholders to the proposed policy goal

No / Yes

Ministria e Drejtësisë në kuadër të detyrimeve që burojnë nga anëtarësimi i Shqipërisë në Partneritetin për Qeverisjen e Hapur (këtu e tutje “PQH” ose “OGP”), nisur fusha e saj e përgjegjësisë ka propozuar angazhime për fushën si më poshtë:

Aksesi në drejtësi, shihet si një nga komponentët kyç të qeverisë shqiptare e ndërlikur fort me

zbatimin e reformës në drejtësi, Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND 2021-2025), Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur (SNDM 2022-2026), Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP 2019-2023), si dhe masat e tjera të ndërmarra nga Qeveria në përbushje të misionit të saj për një qeverisje të hapur, transparente dhe llogaridhënëse.

Aksesi në Drejtësi, në vijim dhe të takimeve të mëparshme të realizuara, paraqiti masat dhe aktivitetet që do të jenë pjesë e përbajtjes së planit të veprimit duke e vënë theksin tek ato që vijnë si propozime të OSHC-ve.

Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi:

2.1. Ndërgjegjësimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi.

2.2. Edukimi i Publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi.

Ndaj dhe masat lidhur me aksesin në drejtësi, propozohen nga këto fusha të cilët synojnë ndërgjegjësimin dhe edukim të publikut mbi aksesin në drejtësi.

Lufta kundër korrupsionit, është një ndër politikat më prioritare, të cilat vendi ynë këshillohet t'i ndjekë me përparësi. Parandalimi, ndëshkimi dhe ndërgjegjësimi i publikut lidhur me luftën Kundër korrupsionit është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentat ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO), Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit etj.

Në vijim dhe të sugjerimeve të takimeve të mëparshme të realizuara, u dakordësuan tre objektiva specifik për këtë komponent;

1.1. Ndërgjegjësimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit.

1.2. Edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat

	<p>në luftën kundër korrupsionit;</p> <p>1.3. Edukimi dhe ndërgjegjësimi i administratës publike për kuadrin ligjor dhe rregullator për antikorrupsionin dhe mekanizmat anti-korrupsion në sektorin publik.</p> <p>MD bëri të njohur propozimet konkrete të saj për masa dhe aktivitete shkëputur nga draft PV e punuar dhe komentoj domosdoshmërinë e tyre në përmbajtje të PV. Kopie e draft PV u shfaq direkt në takim.</p> <p>Masat janë në harmonizim me dokumentet e politikave dhe ato të veprimit që harton dhe ndjek MD me Drejtorinë Antikorrupsion.</p> <p>MD theksoi masat dhe aktivitetet e përfshira në PV ardhur si propozime direkte të OSHC-ve (IDM dhe ALTRI dhe CRCA).</p>
<p>(x) Introduce stakeholders to the OGP process</p>	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Po. Në Takimin e katërt Konsultativ, i cili u mbajt online në Platformën Microsoft Teams, ku u ftuan rreth 70 përfaqësues, pjesëmarrës të ministrive të linjës, të organizatave të shoqërisë civile.</p> <p>Në prezantim shpërnda me pjesëmarrësit draft-plani i veprimit, në përmbajtje të cili ishin të reflektuara sugjerimit e ardhura nga OSHC-të përgjatë gjithë kohëzgjatjes së procesit.</p> <p>Në prezantimin e bërë, pjesë e shkëputur e draftit të PV u pasqyruan angazhimet prioritare finale të Ministrisë së Drejtësisë për dy komponentë të ndarë në “Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat në luftën kundër korrupsionit” si pjesë e fushës së Parë të OGP - “Antikorrupsioni & Integriteti dhe pronarët përfitues” dhe “Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi” pjesë e fushës së Dytë – Aksesit në Drejtësi”.</p> <p>Gjithashtu, pjesëmarrësit u njoftuan se kanë mundësi të konsultojnë dokumentin edhe gjatë periudhës së konsultimit publik të Planit Kombëtar për Qeverisje të Hapur, dokument i cili ka në përmbajtje të gjithë angazhimet prioritare të ndërmarra nga qeveria shqiptare. Ky process do të kryhet nga departamenti</p>

	përgjegjës në KM, por cili do të mbështetet edhe nga MD, nëpërmjet rrjeteve të saj të komunikimit.
(xi) Explain the feedback tools for stakeholders	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes <p>Në Takimin e katërt Konsultativ, i mbajtur online në platformën Microsoft Teams, u realizua një panoramë e gjerë epërmbajtjes së draft planit të veprimit, për fushat respektive të angazhimit të MD.</p> <p>Prezantimi u bë i plotë për masat e ardhura si propozime të MD dhe ato të ardhura si propozime të OSHC-ve, si edhe justifikimi i vendosjes së tyre në angazhimet e MD.</p> <p>Sekretariati teknik që ndjek angazhimin antikorrupsioni gjatë prezantimit të draftit të PV argumentoi gjithashtu, mosmarrjen e dy propozimeve të ardhura nga një prej OSHC, nga IDM, pasi ishin më së shumti të fokusuar tek fusha 7 e OGP: e drejta për informim dhe e përputhshmërisë&konsultim dhe ndikim rregullator , dhe u sugjerua që propozimet për masa dhe aktivitete të dërgoheshin institucionit që ndjek këtë angazhim në PKV të OGP, 2022-2024.</p>
(xii) Brainstorm ideas with stakeholders	<input checked="" type="checkbox"/> No / <input type="checkbox"/> Yes <p>Takimi konsultativ pati komente dhe dakordësi për çështjet e diskutuara dhe për përfshirjen e masave dhe aktiviteteve në PV, gjithashtu edhe për dërgimin e dy masave drejt një angazhimi tjetër.</p>
(xiii) Develop further details (milestones, etc.) for ideas	<input checked="" type="checkbox"/> No / <input type="checkbox"/> Yes
(xiv) Gather feedback on proposed policy goals	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes <p>Takimi i katërt konsultativ, u realizua duke parashtruar draftin e masave/produkteve konkrete, si dhe u dakordësua zhvendosja e dy prej masave të</p>

	<p>propozuara nga IDM, duke u bashkuar me angazhimet prioritare të ndërmarra nga Departamentit të Përputhshmërisë pranë Kryeministrisë. Gjithashtu, u vendos se komunikimi i propozimeve për to do të realizohet nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë.</p> <p>Diskutimet e takimit ishin mjaft frytdhënëse dhe mundësuan konsolidimin e një drafti veprimi shumë të mirë.</p>
(xv) Prioritize proposed policy goals	<input checked="" type="checkbox"/> No / <input type="checkbox"/> Yes
(xvi) Other (provide details)	<input checked="" type="checkbox"/> No / <input type="checkbox"/> Yes
VI. Methodology	
<p>What was the format of the meeting? How were stakeholders able to participate?</p>	<p>Takimi i katërt Konsultativ u organizua online, nëpërmjet Platformës Microsoft Teams. Natyra e takimit ishte e hapur, interaktive dhe frytdhënëse.</p> <p>Link i takimit është: Microsoft Teams meeting Meeting ID: 392 483 177 280 Passcode: jq4nXR</p> <p>Pjesëmarrësit nuk patën vështirësi në ndjekje të takimit.</p>
(v) Presentations	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes <ul style="list-style-type: none"> ✓ Në zhvillimin e takimit u shfaq në prezantim dhe për lehtësinë e të gjithë pjesëmarrësve pjeë nga përmbajtja e planit të veprimit (word).
(vi) Discussion / Feedback from stakeholders	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes

	<p>Gjatë takimit u dakordësuan të gjitha masat e draft planit të veprimit të bashkë-hartuar nga MD dhe OSHC-të propozuese.</p> <p>Propozim i MD për të propozuar dy prej masave të sjella nga IDM tek institucioni që ka angazhim komponentin e konsultimit publik dhe tëpërputhshmërisë (si më lart kreu I- rubrika iii) dhe iv) u dakordësua.</p>
(vii) Questions and answers	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Pjesëmarrësve iu dha mundësia për të bërë pyetje dhe për të diskutuar. Në përgjithësi pati dakordësi lidhur me masat/produktete propozuara dhe konstatime pozitive.</p>
(viii) Brainstorming	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Pjesëmarrësve iu dha mundësia për të bërë pyetje dhe diskutuar mbi draftin paraprak.</p>
Stakeholder Selection	Details
(vi) How were stakeholders selected?	<p>Ministria e Drejtësisë, për shkak të funksionit të saj dhe bashkëpunimit me organizatat si dhe shumë projekteve të ndërmarra në fushën e drejtësisë dhe të fushës antikorrupsion ka përfshirë mjaftueshëm organizata të shoqërisë civile, qendrave studimore, akademisë dhe juristëve tëshquar. Si rrjedhojë, për këtë proces ashtu si për projektet e tjeranë fushën e drejtësisë, u përdor lista e shoqërive civile/grupeve të interesit të cilat kanë lidhje direkte ose indirekte me aksesin në drejtësi, transparencën, llogaridhënien institucionale, integritetin, konsultimin publik, antikorrupsionin. Për shembull, lista e grupeve të interesit, përfshin: shoqatat civile që kanë lidhje direkte me sistemin e drejtësisë dhe prekin tema të ndryshme sociale-ekonomike si, ndihma ligjore për gratë dhe fëmijët apo grupet vulnerabël, ndihmaligjore për rastet e dhunës në</p>

	<p>familje, shoqatat në ndihmë të minoriteteve dhe emigrantëve.</p> <p>Gjithashtu, janë përfshirë fakultetet e drejtësisë së universiteteve shtetërore dhe private sidhe akademike/profesorë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre me lidhje direkte në sistemin ligjor si dhe qendra studimore dhe shoqata që merren me vëzhgimin e veprimtarisë së institucioneve shtetërore me synim kërkimin e llogaridhënies nga ana e qeverisë.</p> <p>Organizatë të specializura dhe fokusuar në projekte bashkëpunimi me politikën dhe nismat antikorrupsion.</p> <p>MD aplikoi edhe njoftimin e hapur për pjesëmarrje në rrjetet e saj sociale të komunikimit.</p>
<p>(vii) How were stakeholders contacted?</p>	<p>Palët e interesuara u ftuan të ishin pjesë e këtij procesi në rrugë elektronike/telefon. Ftesa u shoqërua edhe me agjendën e takimit.</p> <p>MD nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion aplikoi edhe njoftimet për pjesëmarrje në rrjetet sociale të komunikimit si facebook, linkedIn dhe twitter.</p> <p>Shik për më shumë profilet e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit.</p>
<p>(viii) How many stakeholders were contacted?</p>	<p>(Rreth) 70 + njoftim i hapur</p>
<p>(ix) Was the consultation announced publically? (via websites, social media, etc.)</p>	<p>Po. Njoftimi është kryer në rrugë elektronike/via-email, telefon, rrjete sociale të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, me poster të dedikuar për pjesëmarrje si edhe kujtesë.</p>

(x) Were stakeholders reminded?	Po. Palët e interesuara dhe të ftuara në këtë proces janë rikujtuar në rrugë elektronike/ via- e-mail/Telefon rrjete sociale të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, me poster të dedikuar për pjesëmarrje dhe kujtesë në datë 23.02.2023
VII. Results/ Findings	
Stakeholder Contributions	Details
(v) How many stakeholders attended?	12pjesëmarrës
(vi) Did stakeholders contribute?	Po
(vii) Main issues identified by stakeholders	Takimi ishte konsultativ dhe i frutshëm dhe gjatë takimit nga palët prezente u dhanë dakordësia për përfshirjen e masave dhe aktiviteteve në PV.
(viii) Main recommendations from stakeholders?	<ul style="list-style-type: none"> - Ndërgjegjësimi i qytetarëve mbi aksesin në drejtësi; - Krijimi i një instrumenti për monitorimin e institucioneve që kanë plane integriteti; - Informimi i qytetarëve mbi këtë mekanizëm, për akses dhe rrugët e ndjekjes; - Informimi i qytetarëve dhe i organizatave të shoqërisë civile kryesisht mbi korrupsionin dhe mekanizmat për luftimin e korrupsionit; - Vendosja e aktiviteteve dhe produkteve konkrete të OSHC, për vitet e zbatimit të PV, për angazhimin e antikorrupsionit; - Bashkëpunim i vazhdueshëm me DNJF, të nevojshëm që qytetarët të ndërgjegjësohen dhe të njihen më tepër me konceptin e mekanizmave të aksesimit të drejtësisë. - Krijimi i manualëve dhe meodologjive për zbatim nga antikorrupsioni për kapacitetet profesionale të drejtorisë dhe rrjetit AK.
- Shortcomings Identified & Preparations for Next Consultation	
	Details
(v) Limitations in stakeholder attendance	Jo. U ftuan rreth 70 përfaqësues institucionesh, OSHC, akademia, ministritë e linjës, në rrugë elektronike (email) por edhe me thirrje të hapur (facebook/linkedin/twitter).

(vi) Limitations in stakeholder participation	Jo.
(vii) What can be done to improve attendance?	Promovimi në rrjete sociale të angazhimit të Ministrisë së Drejtësisë. Gjithashtu dhe promovimi i faqes se OGP Albania për çdo informacion shtesë.
(viii) What can be done to improve participation in the next meeting?	<ul style="list-style-type: none"> • Inkurajim duke biseduar drejtpërdrejt me palët e interesit për rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre; • Përfshirje e mëtejshme në procesin e konsultimit publik, për tu bërë të draftit të PKV (në vijim).

Stakeholder Feedback

Name:	Znj. Iris Shima	Organization/ Affiliation:	ALTRI	Position:	Menaxhere projekti
Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas					
Comments:					
U shpreh dakord me përmbajtjen e draftit dhe dakord me vendndodhjen e propozimeve të tyre në angazhimet e MD.					
Issues Raised -					
Feedback:					
<ul style="list-style-type: none"> - Është e rëndësishme ndërgjegjësimi dhe informimi i shtuar i qytetarëve për mekanizmat e aksesit në drejtësi. - Rëndësia e bashkëpunimit të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas me KSHH si dhe me OSHC të cilat kanë fokus mekanizmat e aksesit në drejtësi. 					

Name:	Znj. Rovena Sulstarova	Organization/ Affiliation:	IDM	Position:	Menaxhere projekti
Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas					
<p>Comments:</p> <p>U shpreh dakord me përmbajtjen e draftit dhe propozimin për dërgim të dy masave dhe aktiviteteve tyre për përfshirje në një angazhim tjetër të PKV OGP.</p> <hr/> <p>Issues Raised</p> <p>-</p> <hr/> <p>Feedback:</p> <p>Të gjitha sugjerimet të bëra nga IDM (<i>Institute for Democracy and Mediation</i>) janë marrë në konsideratë.</p>					

1. Sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese mbi konceptin e pronarit përfitues dhe detyrimin e regjistrimit dhe të përditësimit të të dhënave të pronarëve përfitues;
2. Vlerësimi i praktikave më të mira të vendeve të Bashkimit Europian mbi procesin e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues dhe integrimi i tyre në praktikat e vendit tonë;
3. Rishikimi i legjislacionit në fushën e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues, në kuadër të përmirësimit të procedurës së ndjekur mbi identifikimin e pronarëve përfitues dhe dokumentet shoqëruese për regjistrimin e të dhënave të tyre.

Mbi takimin e zhvilluar online, me subjektet raportuese dhe grupet e interesit me temë “Prezantimi dhe diskutimi mbi 3 (tre) angazhimet prioritare të Qendrës Kombëtare të Biznesit në kuadër të Iniciativës për Qeverisje të Hapur (Open Government Partnership- OGP) dhe Planit të Veprimit me grupet e interesit”.

Në kuadër të Iniciativës për Qeverisje të Hapur (Open Government Partnership- OGP) dhe Planit të Veprimit, Qendra Kombëtare e Biznesit ka marrë përsipër disa angazhime që lidhen me regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues dhe përditësimin e tyre nga subjektet raportuese, sipas afateve dhe kërkesave të parashikuara në ligjin “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues”, i ndryshuar. Si një hallkë e rëndësishme e këtij procesi, që prej miratimit të kuadrit ligjor dhe aktivizimit të regjistrimit, Qendra Kombëtare e Biznesit organizoi një takim online në datë 27.02.2023 ora 11:00, me subjektet raportuese dhe grupet e interesit me tematikë “Prezantimi dhe diskutimi mbi 3 (tre) angazhimet prioritare të Qendrës Kombëtare të Biznesit në kuadër të Iniciativës për Qeverisje të Hapur (Open Government Partnership- OGP) dhe Planit të Veprimit me grupet e interesit” si më poshtë për:

1. Sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e subjekteve raportuese mbi detyrimin e regjistrimit dhe të përditësimit të të dhënave të pronarëve përfitues.
2. Vlerësimin e praktikave më të mira të vendeve të Bashkimit Europian mbi procesin e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues.
3. Rishikimin e legjislacionit në fushën e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues, në kuadër të përmirësimit të procedurës së ndjekur mbi regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues.

Qendra Kombëtare e Biznesit në datë 22.02.2023 nga adresa zyrtare, dërgoi një ftesë me e-mail subjekteve raportuese dhe grupeve të interesit (lista bashkëlidhur në Aneks 1), ku informoheshin mbi procesin e OGP dhe iniciativën e QKB lidhur me 3 (tre) angazhimet e marra.

Gjatë takimit zhvilluar në datë 27.02.2023 ora 11:00, në hyrje të tij u prezantua një material mbi OGP se çfarë është në vetvete dhe historikun e saj dhe më pasu shpjeguan 3 (tre)

angazhimet, një përshkrim i shkurtës për secilën prej tyre dhe aktivitetet të cilat QKB propozonte.

Nga subjektet raportuese u vlerësua shumë kjo nisëm dhe u shprehën sejanë të gatshëm për bashkëpunim të mëtejshëm. Sugjeruan që në vijim të organizohej një takim nëtryezë për të diskutuar mbi të 3 (tre) angazhimet por me fokus më të madh, për praktikat më të mira të vendeve të Bashkimit European mbi procesin e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues dhe rishikimin e legjislacionit në fushën e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues.

Ky takimi ishte interaktiv dhe në panel u ushtruanpyetje për diskutim nga subjektet raportuese të cilat morën përgjigje dhe sqarime nga përfaqësuesit e Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Në përfundim të takimit online, materiali në powerpoint i ndarë me ta gjatë prezantimit u dërgua dhe në email për të gjithë subjektet raportuese. Duke qenë se ata do të jenë të përfshirë nëçdo aktivitet si grupe interesi ju kërkua të na dërgonin sugjerime të tjera, mbi aktivitete ndryshe nga ato qëne kemi propozuar për të 3 (tre) angazhimet e sipërcituara.

**Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit/AKSHI (4 angazhime prioritare):
Institucioni udhëheqës**

1. Shtimi i të dhënave automatike në portalin e të dhënave të hapura dhe aksesit në Gatishmërinë e të dhënave të hapura (Open Data Readiness).
2. Identifikimi i ngjarjeve proaktive të jetës dhe zbatimi i të paktën 1 ngjarje jetësore (Life Event) në e-Albania në portalin e qeverisë e-Albania.
3. Transpozimi i direktivës së BE-së për aksesueshmërinë në ueb/për portalet qeveritare (Direktiva e aksesueshmërisë në ueb (BE) 2016/2102 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2016 mbi aksesueshmërinë e faqeve të internetit dhe aplikacioneve celulare të organeve të sektorit publik”).
4. Zhvillimi i mekanizmit të vlerësimit nga ana e qytetarëve për shërbimet elektronike.

CONSULTATION 1

Consultation Details

Policy Goal Focus	<p>Angazhime të propozuara</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillimi i procesit të digjitalizimit dhe e-qeverisjes 2. Përshtatja e e-albania për personat me aftësi të kufizuara. 3. Shoqëria Civile si pjesë e rëndësishme dhe integrale e punës për hartimin e akteve ligjore dhe testimin e vazhdueshëm për përmirësimin e portalit
Lead Focal Point Institution	<ul style="list-style-type: none"> • Znj. Romina Kostani/Drejtor, Drejtorja e Inovacionit dhe Promovimit e-Gov
Date	27.02.2023
Consultation Meeting Number	2

II. Objective of Consultation Meeting

<p>What was the aim of this consultation? Please answer for all that apply</p>	<p>Details:</p> <p>Takimi u moderua nga znj.Romina Kostani, Drejtor, Drejtorja e Inovacionit dhe Promovimit e-Gov, e cila diskutoi në lidhje me arsyen e këtij takimi në kuadër të bashkëhartimit të planit të ri të</p>
---	--

	<p>veprimet për partneritetin për qeverisjen e hapur për periudhën 2022-2024.</p> <p>U diskutua në lidhje me Qeverisjen Dixhitale për shërbimet elektronike në portalin e-albania, dhe portalin Open Data për shtimin e të dhënave të hapura nga institucioneve publike Shqiptare. Numri në total i shërbimeve elektronike të ofruara në e-albania për vitin 2022, arriti në 1227 shërbime, 95% e shërbimeve ofrohen online, ndërsa 5% vetëm rastet kur duhen personat fizikisht për të kryer shërbimin.</p> <p>U fol rreth angazhimeve të propozuara nga AKSHI për planin e ri të veprimet OGP 2022-2024 për fazën finale në lidhje me 4 angazhimet të cilat kanë më tepër impakt te qytetarët dhe bizneset</p> <p>Përsa I përket portalit Open Data, vlerësohet se ka ende vend për të përmiresuar, dhe se është I nevojshëm angazhimi I Shoqërisë Civile, Start Up-eve, akademikeve, etj që të sugjerojnë se çfarë të dhënash të hapura janë të vlefshme në përdorimin për arsye kërkimore, studimore, për zhvillime aplikacionesh etj.</p>
--	--

(xvii) Introduce stakeholders to the proposed policy goal	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Open Data: Ky angazhim do të vërë në dispozicion të dhëna të reja te hapura nga institucione publike permes kryerjes së një analize për identifikimin e të dhënave të hapura, si dhe do të zhvillojë strategji komunikimi për të përmirësuar kuptimin e qytetarëve për përdorimin dhe aplikimin e Portalit të të Dhënave të Hapura me qëllim rritjen e aksesit të qytetarëve.</p> <p>Aksesibiliteti: Aktualisht, disa përmirësime teknike janë bërë në faqet e internetit të ministrive, duke u lejuar atyre me aftësi të kufizuara t'i qasen më lehtë. Masat e parashikuara në Planin Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2021-2025, lidhen më gjerësisht me përmirësimet në kuadrin ligjor si dhe me përmirësimet teknike, si zhvillimi/përshtatja e standardeve për sigurimin e aksesueshmërisë, për të siguruar që personat me aftësitë e kufizuara kanë</p>
---	--

	<p>akses të barabartë në faqet e internetit të sektorit publik, shërbimet, aplikacionet dhe përmbajtjen e tyre dhe veçanërisht në portalin e-Albania.</p> <p>Implementimi i një Life Event: Ngjarjet e jetës janë ngjarje që kanë një ndikim të rëndësishëm në jetën e një qytetari/palësh të interesuar dhe që garantojnë ndërgjegjësimin ose përfshirjen e qeverisë. Shërbimet publike elektronike proaktive do t'u përgjigjen ngjarjeve të jetës me burokraci minimale. Nëpërmjet shërbimeve proaktive dhe të bazuara në ngjarje të jetës, ky angazhim do të ndihmojë që shërbimet publike t'u ofrohen automatikisht në raste të caktuara qytetarëve dhe bizneseve, ndryshe nga qasja aktuale ku në çdo rast është përdoruesi ai që kërkon shërbimin.</p> <p>Feedback-u i qytetarëve: Mekanizmi i përmirësuar për Feedback-un e qytetarëve do të mundësojë veç mbledhjes së komenteve, edhe analizimin automatik të tyre për t'u dhënë anëtarëve të stafit informacion të saktë mbi atë që duhet përmirësuar. Kjo mundëson përfshirje qytetare dhe ndërveprimë të mirëndërmjet qeverisë dhe qytetarëve. Ai gjithashtu siguron një kuadër të hapur dhe të përgjegjshëm për një vendimmarrje më të mirë dhe rrit besimin e publikut.</p>
(xviii) Introduce stakeholders to the OGP process	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Po. Në Takimin e dytë online konsultativ janë ftuar rreth 22 përfaqësues, të organizatave të shoqërisë civile, akademisë, institucioneve publike që kanë veprimtari institucionale të fushës, dhe aktorë të tjerë të interesuar, të cilëve iu dha informacioni i detajuar për procesin e bashkë-hartimit të PKV 2022-2024 të OGP, dhe të parimeve të nismës.</p>
(xix) Explain the feedback tools for stakeholders	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Në Takimin e dytë Konsultativ, i mbajtur Online nëpërmjet platformës Microsoft Teams, Znj. Romina Kostani/Drejtor, Drejtoria e Inovacionit dhe Promovimit e-Gov, dha një prezantim shterues të procesit të OGP, si dhe të detyrimeve dhe angazhimeve konkrete për komponentët respektivë të AKSHI-t.</p> <p>Pjesëmarrësve në takim iu dha mundësia për të kontrolluar dhe pare draftet e dërguara nga AKSHI duke dhënë komentet dhe sugjerimet e tyre</p>

	me email, ose brenda takimit online që u zhvillua.
(xx) Brainstorm ideas with stakeholders	<input checked="" type="checkbox"/> No / <input type="checkbox"/> Yes Takim konsultativ 2, u ritheksua rëndësia e këtyre angazhimeve edhe nga shoqëria civile si dhe përfshirja e sa më shumë grupeve të interesit në përshtatjen e e-albanias për të gjitha grupet e PAK.
(xxi) Develop further details (milestones, etc.) for ideas	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes <ol style="list-style-type: none"> 1. Riorganizimi i portalit e-albania, për ta bërë më të aksesueshëm për qytetaret, për t'i bërë shërbimet me të thjeshta për qytetaret, dhe për t'i kategorizuar në lidhje me ngjarjet e jetës. Në një moment të caktuar do e kenë me të thjeshtë gjetjen e tyre në një kategori. 2. Në kuadër të ofrimit të shërbimeve elektronike në mënyrë universale, dhe të barabartë për të gjitha kategoritë e popullsisë do përshtatet portal e-albania për standartet kombëtare të aksesueshmërisë, në mënyrë që edhe e PAK 3. Mbledhja e feedback, apo e mendimeve të qytetareve në lidhje me shërbimet në e-albania, me përvojën apo vështirësitë që ata hasin si dhe analizim automatik i tyre për vendimmarrje me të shpejta dhe me të mira gjatë procesit të përmirësimit të shërbimeve.
(xxii) Gather feedback on proposed policy goals	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes Takimi i dytë konsultativ, ishte në format shpjegues për të gjithë aktorët, lidhur me Shoqërinë Civile si pjesë e rëndësishme dhe integrale e punës për hartimin e akteve ligjore dhe testimin e vazhdueshëm për përmirësimin e portalit në ndihmë të kësaj fashë. Kërkesës sëAKSHI-it për propozime të reja dhe përfshirjes në angazhime prioritare, në takim pati shumë interes dhe morëm sugjerime dhe propozime nga OSHC të cilat do të jenë të listuara më poshtë.
(xxiii) Prioritize proposed policy goals	<input checked="" type="checkbox"/> No / <input type="checkbox"/> Yes

(xxiv) Other (provide details)	<input checked="" type="checkbox"/> No / <input type="checkbox"/> Yes
IX. Methodology	
What was the format of the meeting? How were stakeholders able to participate?	Takimi i dytë Konsultativ u organizua Online, i hapur dhe interaktive. Microsoft Teams meeting Meeting ID: 340 91327979 Passcode:LaT3Q2
(ix) Presentations	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes Shoqërisë Civile i është prezantuar dhe janë njohur me draftet zyrtare, ku gjenden angazhimet specifike nga ana e AKSHI-t në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimtimit 2022-2024.
(x) Discussion / Feedback from stakeholders	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes Gjatë takimit, përveç propozimeve konkrete që morrëm gjatë diskutimit me Shoqërinë Civile, gjithashtu u dakordësua që çdo propozim i mundshëm të dërgohet elektronikisht në adresat e kontaktit, me qëllim caktimin e angazhimeve prioritare të PKV 2022-2024.
(xi) Questions and answers	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes Pjesëmarrësve iu dha mundësia për të bërë pyetje si dhe për të dhënë sugjerimet e tyre përkatëse për këtë angazhim.
(xii) Brainstorming	<input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes Pjesëmarrësve iu dha mundësia për të bërë pyetje dhe diskutuar duke u dhënë dhe disa sugjerime në lidhje me përmirësimin në portal.
Stakeholder Selection	Details
(xi) How were stakeholders selected?	Pjesëmarrësit u përzgjedhën në kuadër të bashkëpunimit që ka AKSHI, me OSHCveprimtaria e së cilaveka të bëjë me PKV për 2022-2024 Gjithashtu, pjesëmarrësit u selektuan edhe nga kontaktet dhe eksperiencat e mëparshme të ngjashme, me qëllim gjithëpërfshirjen në këtë

	proces.
(xii) How were stakeholders contacted?	Palët e interesuara u ftuan të ishin pjesë e këtij procesi në rrugë elektronike dhe telefon. Ftesa u shoqërua edhe me agjendën e takimit, si dhe unjoftuan për të kontrolluar dhe për t'i parë draftet në lidhje me angazhimet e AKSHI-t, për të cilat do të jepnin komentet dhe sugjerimet e nevojshme nga ana e tyre.
(xiii) How many stakeholders were contacted?	OSHC (22) Startupe (137 persona)
(xiv) Was the consultation announced publically? (via websites, social media, etc.)	Po. Njoftimi është kryer në rrugë elektronike/via-email dhe telefon.
(xv) Were stakeholders reminded?	Po. Palët e interesuara dhe të ftuara në këtë proces janë rikujtuar në rrugë elektronike/ via- e-mail. <ul style="list-style-type: none"> • Email i parë që përfshin vënien në dijeni për takim: 23/02/2023. • Email i dytë rikujtues që përfshin linkun e pyetësorit: 26/02/2023. • Email i tretë, 27/02/2023, rikujtesë në orën 8:00am, 1 orë përpara fillimit të takimit.
X. Results/ Findings	
Stakeholder Contributions	Details
(ix) How many stakeholders attended?	11 pjesëmarrës gjithsej (8 nga OSHC-të)
(x) Did stakeholders contribute?	Po.
(xi) Main issues identified by stakeholders	Takimi ishte konsultativ dhe gjatë takimit palëve prezentiu dhanë këshilla dhe kërkesa për propozime dhe përfshirje nëangazhimet e PKV 2022-2024.
(xii) Main recommendations from stakeholders?	Thjeshtimi sa më i madh i portalit në mënyrë që të sjellë aksesueshmërinë sa më të lehtë e të madhe të personave me aftësi të kufizuara.
XI. Shortcomings Identified & Preparations for Next Consultation	
	Details
(ix) Limitations in stakeholder attendance	Jo. U ftuan përfaqësues institucionesh, OSHC,

	akademia, në rrugë elektronike (email)
(x) Limitations in stakeholder participation	Po. Organizatat shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e institucioneve të ftuar në proces ishin 8.
(xi) What can be done to improve attendance?	Promovimi në rrjete sociale të angazhimit të AKSHI-t.
(xii) What can be done to improve participation in the next meeting?	<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i një ure të përbashkët midis aktorëve të interesuar dhe AKSHI-t do të ndikojë në ofrimin e propozimeve dhe kontributeve për të përmirësuar secilin nga fushat përkatëse gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre; • Inkurajim duke biseduar drejtpërdrejt me palët e interesit për rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre;

Stakeholder Feedback

Name:	Z. Ergest Nako	Organization/Affiliation:		Position: Përfaqësues	
Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas					
<p>Comments: Z.Ergest Nako, u shpreh pozitiv në lidhje me iniciativën dhe sugjeroi që të gjitha institucionet shtetërore të përdornin të njëjtën gjuhë në një faqe qeveritare.</p>					
<p>Issues Raised: Përgatitja e bazës ligjore për transpozimin e direktivës së BE për aksesueshmërinë, do ishte e nevojshme që kjo direktive të mos transpozohet me ligj, sepse në këndvështrimin teknik standarte të tilla përditësohen shumë shpesh; ndonjëherë ligji mund të mos jetë mënyra më e mirë për të qasur dhe mund të krijojë barrierën e burrokracisë,</p>					
<p>Feedback: Z. Nako sugjeron në dokument të gjallë, që t'i lejonte institucionit zhdërvjelltësinë e përditësimin e atij dokumenti pa patur nevojë që të kalojë të gjithë hallkat e kalimit të një ligji. U sugjerua të autorizohet ai dokument me ligj/VKM dhe me pas të kihet mundësia e përditësimit të herëpashershëm, në varësi të ndryshimit të standardeve ndërkombëtare.</p> <p>z. Nako dha edhe një sugjerim mbi feedback mechanism: Te shihet Promoter Story e cila ka rezultuar një mjet shumë i suksesshëm për të marrë vlerësimin e përdoruesve.</p>					

Name:	Z. Emiliano Lule	Organization/ Affiliation :	Drejtor i Institutit Visum	Position: Ekspert i Aksesueshmërisë	
Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas					
<p>Comments: Z. Luleshprehu gatishmërinë dhe mjaft interes për sa i përket angazhimeve të AKSHI-t, duke dërguar një Raport për Modelet Më Të Aksesueshme të Ndërfaqeve Web.</p> <p>Raportipërfshinte modelet më të aksesueshme të ndërfaqeve web, standardet dhe nivelet e aksesueshmërisë, si dhe gjithashtu modelet më të mira të teknologjive asistive, modelet më të mira të aksesueshmërisë të organizatave të njerëzve që nuk shikojnë, modelet më të mira të aksesueshmërisë të platformave të edukimit online, modelet më të mira të aksesueshmërisë të ndërfaqeve të institucioneve të pushtetit vendor.</p>					
Issues Raised: -					
<p>Feedback: Disa nga sugjerimet kryesore nga raportii z.Lulene lidhje me aksesueshmërinë janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ndërfaqet mund të navigohen edhe nëpërmjet kombinimeve në tastierën kompjuterike, videot kanë shpjegime me titra dhe nuk ka nënkuptime ose shpjegime të tjera të cilat varen nga format, ngjyrat ose përmasat. 2. Ndryshimi i kontrastit duhet të jetë në një nivel më të lartë, imazhet duhet të jenë me shpjegim të tekstit alternativ për të verbërit, navigimi duhet të jetë i qartë dhe shkrimi duhet të jetë i ndarë me kryeradhë për të kuptuar çfarë ka në çdo seksion pasardhës. 3. Kontrasti i ngjyrave duhet të jetë pothuajse bardh e zi, videot duhet të kenë shpjegim të gjuhës së shenjave, nuk duhet të jenë të ndërhuara pa një radhë të caktuar dhe kur paraqitet nevoja për të kuptuar më shumë rreth një konteksti duhet të kenë shpjegime të fshehura që shfaqen vetëm për këtë qëllim. 4. Implementimi i teknologjisë “text to speech”: Teknologjia që duhet implementuar konsiston në tre nënkategori të aksesueshmërisë: <ol style="list-style-type: none"> a. ndërfaqja e internetit që përmban materialin e publikuar online, b. lloji i programit i cili do të përdoret për të naviguar ose shfletuar informacionin në web, c. tipologjia e programit (screen reader) lexues me sintezë vokale që do të lexojë materialin e shfletuar nga programet për navigim/ shfletim si google chrome, Firefox, Internet Explorer, Microsoft Edge në Microsoft Windows, apo Safari në sistemin operativ MacOS. 					

Name:	Z.Abdulla Omuri	Organization/ Affiliation:	Shoqata e Invalidëve të Punës	Position:	Kryetar
Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas					
Comments: Z. Omuriu shpreh se është optimist në lidhje me nismën, për lehtësimin që i bëhet kësaj fashe.					
Issues Raised: -					
Feedback: Z. Omurie filloi me sugjerimin mbi ligjin e aksesueshmërisë, ligji 93 i 2014, i cili duhet përsosur me vkm. Një nga diskutimet është “Aksidentet në punë”, ligji I punësimit në favor të nenit 27, duhet të gjenden rrugët për ballafaqimin e punëdhënësit dhe familjarit si dhe te shihet mundësia e plotësimit online te formularit te raportimit te punëdhënësit ne rastet e ndodhjes se nje aksidenti ne punë. Të përcaktohet se kompetencë e cilit institucion duhet të jenë aksidentet në punë (e Ministrisë se financave apo e Sigurimeve Shoqërore). Një sugjerim edhe në lidhje me tatimet ku ligji detyron OJF për të patur NIPT, në bazë te ligjit detyron që kjo kategori të përjashtohet nga disa taksa. Ky proces kryhet në drejtoritë rajonale dhe nëse është e mundur të bëhet online, në mënyrë që personat me aftësi ndryshe ta kenë më të lehtë.					
STAKEHOLDER ATTENDANCE					

Ministria e Mbrojtjes

1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi rolin dhe misionin e MM dhe FARSH, si dhe mbi krijimin e një sistemi mbrojtës të qëndrueshëm bazuar në inovacionin teknologjik

Ministria e Mbrojtjes do të prezantohet dhe do të angazhohet në PKV të OGP 2022-2024, me angazhimin prioritar: *Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi rolin dhe misionin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë si dhe mbi krijimin e një sistemi mbrojtës të qëndrueshëm, bazuar në inovacionin teknologjik në fushëne promovimit të transformimit digjital dhe inovacionit.*

Ministria e Mbrojtjes përfshihet për herë të parë në procesin e hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit 2022-2024, të Partneritetit për Qeverisje të Hapur.

Ky angazhim përkon edhe me disa nga objektivat strategjike të Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes 2022-2025 të cilat janë:

- Përmirësimi i procesit të politikave dhe mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes demokratike;
- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së Ministrisë së Mbrojtjes;
- Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Forcimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm;
- Forcimi i integritetit në operacione dhe misionet ndërkombëtare.

Në datën 24 shkurt 2023 u organizua nga Ministria e Mbrojtjes takimi/konsultimi online me organizatat të shoqërisë civile mbi aktivitetet e propozuara nga MM në zbatim të angazhimit të ndërmarrë, si dhe mbi propozimet e tyre lidhur me këtë angazhim. Takimi u zhvillua në platformën zoom me koordinata:

<https://us02web.zoom.us/j/87307089173?pwd=eFhJeUhLM1pwS01XM3plZXJsdHhaUT09>

Meeting ID: 873 0708 9173, Passcode: 056886

Paraprakisht, nëpërmjet email-it organizatat ishin njohur me draftin e aktivitetëve, i cili iu dërgua për konsultim dhe sugjerime 12 organizatave, si dhe ishin rikujtuar për datën e zhvillimit të takimit.

Drafti i aktiviteteve u hartua nga Drejtoria e Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve, në bashkëpunim me Drejtorinë e bashkëpunimit civilo-ushtarak dhe u konsultua me struktura të tjera të varësisë të MM-së.

Në këtë takim morën pjesë tre organizata: Shoqata Kombëtare për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (ALBICT), Dhoma Ekonomike e Gruas dhe Oficina.

Gjatë takimit u prezantua drafti i Planit të Aktiviteteve në zbatim të angazhimit prioritar të MM-së, dhe u diskutua lidhur me bashkë-angazhimin e këtyre shoqatave në përmbushje të prioritetit.

Propozimet e MM-së gjetën miratimin e pjesëmarrësve si dhe propozimet e organizataveu dërguan edhe me mail në adresën e pikës së kontaktit, dhe u pasqyruan në Planin e Aktiviteteve të paraqitur nga MM-ja.

Ministria e Financës dhe Ekonomisë

1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transparencën buxhetore
2. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transparencën e të ardhurave
3. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi financat publike

Pas miratimit të angazhimeve prioritare nga Komiteti Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë vijoi procesin për hartimin e analizës së situatës, problematikave specifike dhe identifikimin e aktiviteteve specifike që do të duhet të kryhen sipas afateve kohore për çdo angazhim. Për fushën 4: Transparenca fiskale, për të cilën institucion udhëheqës është Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nga Komiteti Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur u miratuan tre angazhimet prioritare si në vijim:

1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transparencën buxhetore
2. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi transparencën e të ardhurave
3. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi financat publike

Në kuadër të rolit tepër të rëndësishëm dhe kyç të Organizatave të Shoqërive Civil edhe grupeve të interesit në procesin e bashkë-hartimit të planit të veprimit 2022-2024 për OGP-në, nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 21 shkurt 2023, u kërkua angazhimi dhe kontributii OSHC-ve për të identifikuar aktivitetet specifike për secilin angazhim prioritar të miratuar që do të jenë pjesë e Planit të Veprimit të OGP-së 2022-2024. Gjithashtu, OSHC-ve iu përcoll ftesa për pjesëmarrje në takim për të diskutuar për këtë qëllim (ftesa bashkëlidhur).

Takimi konsultues u zhvillua në datën 23 shkurt 2023. Në takim morën pjesë përfaqësues nga 4 OSHC, konkretisht nga ‘Albanian Initiative for Development’, ‘Instituti I Politikave të Qëndrueshme’, ‘Save the Children’, ‘Gender Alliance for Development Center’ dhe përfaqësues nga disa drejtori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Zhvillim pozitiv në këtë proces ishte pjesëmarrja në takim e ‘Gender Alliance for Development Center’, organizatë e cila nuk ishte pjesë deri në këtë fazë.

Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen

1. Promovimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes, nëpërmjet krijimit të një klime dhe mjedisi mbështetës për sipërmarrjen.

Në kuadër të fazës së tretë për përgatitjen e Planit Kombëtar të Veprimit 2022-2024 pranë ambienteve të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes u zhvilluan dy takime.

Takimi i parë u zhvillua ditën e Hënë datë 20/02/2023 orën 12:00 me përfaqësues nga Destil Creative Hub (OJF) dhe Akademia e Grave Sipërmarrëse në Shqipëri. Në këtë takim u diskutua mbi procesin e hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2022-2024, si dhe ju vendos në dispozicion edhe formati i Planit të Veprimit. Takimi informues zgjati dy orë dhe Znj. Sonila Abdalli u tregua e gatshme të jap kontributin e saj edhe në fazën e tretë të këtij procesi.

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ka realizuar disa aktivitete dhe takime me Destil Creative Hub, ku i fundit është ai i datës 19/12/2022 pranë ambienteve të Ministrisë. Të pranishme në këtë takim ishin edhe Akademia e Grave Sipërmarrëse në Shqipëri një projekt që implementohet nga Destil Creative Hub.

Destil është një qendër multifunktionale bashkëpunimi, që operon me fokus te promovimi, zhvillimi dhe fuqizimi i ekosistemit të sipërmarrjes në vend. Është një hapësirë e krijuar për njerëzit krijues inovatorë që të punojnë mbi projektet e tyre, të shkëmbejnë njohuri nga eksperiencat e tyre, praktika vendase dhe ndërkombëtare, si edhe të ekspozojnë krijimet e tyre. Destil është specializuar në bashkëpunimet e suksesshme të projekteve pilot partner dhe start-up

Takimi i dytë u zhvillua online në platformën Teams më datë 23 Shkurt 2023, nga ora 10:00 deri në orën 12:00. Diskutuam me Znj. Sonila Abdalli lidhur me plotësimin e formatit për Planin e Veprimit 2022-2024, sipas angazhimeve prioritare të miratuara nga Komiteti OGP.

Gjithashtu pjesë e diskutimit ishte edhe bashkëpunimi në vazhdimësi dhe realizimi i aktiviteteve të Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes me qendrën Destil Creative Hub. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes është gjithmonë mbështetës ndaj çdo

sipërmarrje si dhe promovon transparencën dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, për përmirësimin e shërbimeve publike, si dhe asiston sipërmarrjen në mbrojtjen e të drejtave të tyre ligjore të lidhura me aktivitetet e tyre sipërmarrëse, kundrejt institucioneve publike; ndërmjetëson komunikimin dhe zhvillimin e partneritetit të sipërmarrjes me institucionet publike; identifikon pengesat e biznesit në sektorë të caktuar të ekonomisë dhe formulon strategjitë e ndërhyrjes për reduktimin e barrierave administrative.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

1. Ndërgjegjësimi dhe informimi i publikut në mënyrë të veçantë i grupeve në nevojë lidhur me aksesin në shërbimet gjithëpërfshirëse.
2. Fuqizimi i kapaciteteve të profesionistëve, me përgjegjësi në ofrimin e shërbimeve për kategoritë më vulnerabël si: fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara, Romët dhe Egjiptianët, LGRBTI, të moshuarit.
3. Forcimi i bashkëpunimit dhe mekanizmave monitorues me aktorët e shoqërisë civile me përparësi ndaj grupeve të veçanta;

Takim konsultimi për masat dhe aktivitet e Dokumentit të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur

Data 22.02.2023

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nisur nga fusha e përgjegjësisë dhe legjislacionit në fuqi, konsultohet për dokumentat strategjikë dhe legjislacionin me OSHC. Në kuadër të Dokumentit të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur, nisur fusha e saj e përgjegjësisë ka propozuar angazhime për secilën fushë si më poshtë:

1. Ndërgjegjësimi dhe informimi i publikut e në mënyrë të veçantë i grupeve në nevojë lidhur me aksesin në shërbimet gjithëpërfshirëse.
2. Fuqizimi i kapaciteteve të profesionistëve, me përgjegjësi në ofrimin e shërbimeve për kategoritë më vulnerabël si: fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara, Romët dhe Egjiptianët, LGBTI, të moshuarit.
3. Forcimi i bashkëpunimit dhe mekanizmave monitorues me aktorët e shoqërisë civile me përparësi ndaj grupeve të veçanta;

Këto prioritete ishin ndarë paraprakisht me pjesëmarrësit. Pas diskutimeve dhe gjetjeve nga pyetësi për procesin e bashkë-bërjes janë miratuar prioritetet/angazhimet e mësipërme.

Me qëllim shtjellimin në masa dhe aktivitete dhe sipas metodologjisë oë OGP u zhvillua një takim në platformë online Microsoft teams në datën 22. 02.2023.

Të pranishëm në takim ishin organizata që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve, grave apo grupeve vulnerabël në përgjithësi sic janë

- ✓ Qendra për të Drejtat e Fëmijëve CRCA,
- ✓ Nisma Arsis
- ✓ Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci” (QDNJD),
- ✓ Streha LGBTI,
- ✓ Pro LGBT,
- ✓ Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

Këta aktorë punojnë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri dhe kryejnëaktivitete ndërgjegjësimi për të drejtat e njeriut, me fokus të veçantë grupet më vulnerabël të shoqërisë; siç janë grate/vajzat, të miturit, minoritetet etj.

Znj. Etleva Sheshi prezantoi 3 prioritetet e miratuara, informoi për procesin e bashkëbërjes si një process ku kërkohet që shoqëria civile të forcojë advokimin dhe ë fuqizojë grupet e margjinalizuara nëpërmjet ndërgjegjësimi, trajnimeve, ngritjes së kapaciteteve, me focus gratë/vajzat e zonave rura, fëmijët dhe grupe të vecanta si RomëtLGBTI etj.

Bashkëpunimi i MSHMS me OSHC të cilat veprojnë (perfaqësojnë ose ofrojnë shërbime për kategoritë vulnerabël)në fushën e Barazisë Gjinore, Aftësisë së Kufizuar , Mbrojtjes së të Drejtave dhe Mbrojtjes së Fëmijëve ,Mbrojtjes së të drejtave të komunitetit LGBTIQ+, Integritit të Romëve dhe Egjiptianeve, Mbrojtjen dhe Përfshirjen e të Moshuarve,

Shërbimet dhe cilësia mund të përmirësohen duke fokus të vecantë tek të rinjtë, grupet e margjinalizuara.

Më tej OSHC u dakordësuan me prioritetet dhe theksuan se është e nevojshme që të masat të kenë ndikim tek përfituesit. Pjesëmarrësit në takim vlerësuan angazhimet e propozuara dhe rëndësinë e procesit të bashkëbërje për ofrimin e shërbimeve në komunitet pranë përfituesve dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre sipas legjislacionit në fuqi.

Nga ana e MSHMS u kërkua që të kishte një dakordësim për këto tre prioritetet dhe sipas aktivitetit të ofr të dërgoheshin propozime për masa për secilin prioritet.

Takim konsultimi për masat dhe aktivitet e Dokumentit të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur

Data 24 02.2023

Në takimin online të datës 24..02.2023 pati pjesëmarrje nga

- ✓ AMAD Qender për të drejtat e të rinjve dhe Grave,
- ✓ Nisma Arsis,

- ✓ Observatori për të Drejtat e Fëmijëve ,
- ✓ Linja kombetare e keshillimit Alo 116 111
- ✓ Eorld Vision
- ✓ “Ndhmoni Jetën”

Këto organizta përfaqësojnë fëmijët dhe familjet në nevojëm si dhe ofrojnë shërbime psikosociale dhe mbështetëse për grupet vulnerabël.OSHC vlerësuar faktin që këto prioritet janë gjithëpërfshirëse, nxitin pjesëmarrjen, transparencën

Me qëllim shtjellimin në masa dhe aktivitete dhe sipas metodologjisë oër OGP u zhvillua një takim në platformë online Microsoft teams në datës 24. 02.2023.

Të gjitha Oshc mund të kontribuojnë në zbatimin dhe ndërgjegjësimime një aktiviteti/iniciative konkrete duke dhënë kontribut nëpërmjet projekteve që zbatohen në fusha të ndryshme që lidhen me kadrin e Planit Kombëtar të Veprimit, 2022-2024 të Partneritetit për Qeverisje të Hapur

Nga OSHC u vlerësua se duhej një proces i hapur dhe

- ✓ Forcimi i bashkëpunimit dhe mekanizmave monitorues me aktorët e shoqërisë civile me përparësi ndaj grupeve të veçanta është i rëndësishëm
- ✓ Pjesëmarrja dhe zëri i të rinjve, në procese hartimi politikash, monitorimi dhe vlerësim nevojash.
- ✓ Ndarje e praktikave të mira për buxhetimin rinor në nivelvëndor
- ✓ Vlerësimi të situatës së fëmijëve dhe familjeve ne nevojë për cdo bashki në vend periodikisht;
- ✓ Fushata komunikimi dhe ndërgjegjësimi të përbashkëta

Ministria e Brendshme

1. Rishikimi i Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) me qëllim garantimin e funksionimit të vazhdueshëm efektiv dhe efikas të tij nëpërmjet grupeve vendore të koordinimit për të siguruar aplikimin e vazhdueshëm të standardeve dhe PSV-ve për trajtimin e personave të trafikuar

Më datë 27shkurt 2023, ora 12:30, u zhvillua takimi konsultativ,i organizuar nga Ministria e Brendshme, me anëtarë të Mekanizmit Kombëtar të Referimit, përfaqësues të shoqërisë civile

Në takim morën pjesë:

1. Znj. Silvana Banushi, Drejtore e Përgjithshme/MB
2. Znj. Alma Mele, Drejtor/MB
3. Znj. Alketa Gaxha, IOM
4. Znj. Eljona Elmazi, World Vision
5. Znj. Stela Tanellari, D&E
6. Znj. Diana Kasa, Qendra “Tjetër Vizion”
7. Znj. Luljeta Qose, Qendra “Tjetër Vizion”
8. Znj. Brikena Puka, Qendra Psiko-Sociale “Vatra”
9. Znj.Enkelejda Kallçiu, Terre des Hommes
10. Znj. Renata Cenko, Terre des Hommes
11. Znj. Ana Stakaj, Mary Loreto Foundation
12. +Znj. Mimoza Qyra, Përgjegjëse në Sektorin e Antitrafikut

Takimi u kryesua nga Drejtoresha e Përgjithshme e Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin,**znj. Silvana Banushi**, e cila, në fjalën e sajfalënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen

në takim. Më tej, znj. Banushi vuri theksin tek tema e diskutimit të takimit, e cila ishte angazhimi i Ministrisë së Brendshme për Planin Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur (OGP) 2022-2024.

Në vijim **znj. Banushi**, prezantoi disa çështje të planit kombëtar të veprimit OGP, duke nënvizuar rëndësinë e shoqërisë civile në përmbushjen dhe realizimin e tij. Më tej Znj. Banushi nënvizoi angazhimin e përbashkët të strukturave shtetërore dhe joshtetërore në rishikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit, duke vënë theksin tek kontributi i anëtarëve të MKR-së në draftimin e marrëveshjes.

Znj. Melenë vizoi rëndësinë që ka hartimi dhe zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur dhe se nevojitet angazhim i përbashkët në hartimin e kalendarit të aktiviteteve dhe në zbatimin e tyre.

Znj. Pukapërmendi modelin pozitiv të funksionimit të MKR-së deri tani, duke theksuar se është një ndër mekanizmat që ka funksionuar më mirë se mekanizmi i dhunës, mekanizmi i mbrojtjes së fëmijëve, etj.

Znj. Gaxha propozoi që të zhvillohet një takim për ceremoninë e nënshkrimit të Marrëveshjes, duke i dhënë edhe rëndësinë e merituar procesit.

Znj. Kallçiu propozoi që aktivitetet të zhvillohen të përbashkëta dhe të koordinohen mes partnerëve.

Më pas, pjesëmarrësit propozuan disa sugjerime, sa i takon aktiviteteve. Konkretisht:

Tek aktiviteti 1 u propozua që të formulohej aktiviteti: “**Aktivite në kuadër të Muajit të Luftës kundër Trafikimit të Personave**”, si dhe u sugjerua ndryshimi i afateve të zbatimit **-6 majori i dytë i vitit 2023**.

Si aktivitet 2 u sugjerua: **Takime ndërgjegjësuese me grupet vulnerabël lidhur me trafikimin e personave dhe mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit**, si dhe u sugjerua që ky aktivitet të shtrihej **në periudhën maj-dhjetor 2023**.

Aktivitet 3 u propozua të shtohet: forume diskutimi/sesioni informimi.....në zonat rurale dhe urbane, me një afat zbatimi gjatë 6-mujorit të I të vitit 2023.

Gjithashtu, u propozua nga IOM, shtimi i një aktiviteti: Finalizimi i Marrëveshjes së bashkëpunimit për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit dhe nënshkrimi i saj nga anëtarët. Afati i nënshkrimit të marrëveshje është 6 majori i dytë i vitit 2023.

Tek pjesa narrative e ekzekutivit, bazuar në sugjerimin e pjesëmarrësve, u shtua paragrafi: Ky është instrumenti më i rëndësishëm, nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve ndërgjegjësuese, sesioneve të informimit, trajnimeve dhe workshopeve me profesionistë, etj.

Në përfundim pjesëmarrësit u dakordësuan që, brenda ditës së sotme do të sillnin mendimet/komentet dhe sugjerimet lidhur me fishën për angazhimin e MB-së.

Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë, Kryeministria

1. Vlerësimi i ndikimit, programimi i akteve rregullatore dhe konsultimi publik të jenë në themel të një sistemi politik-bërjeje të bazuar në të dhëna, të mirë planifikuar dhe që mundëson aksesin e publikut në vendimmarrje, për një qeverisje demokratike, transparente dhe llogaridhënëse.

Detajet e angazhimit	
Angazhimi i ndërmarrë	Vlerësimi i ndikimit rregullator, programimi i akteve rregullatore dhe konsultimi publik të janë në themel të një sistemi politikë-bërjeje të bazuar në të dhëna, të mirë planifikuar dhe që mundëson përfshirjen e publikut në vendimmarrje, për një qeverisje demokratike, transparente dhe llogaridhënëse.
Pikat fokale të institucionit	<ul style="list-style-type: none"> • Znj. Sofia Kaloshi - Koordinator, Njësia e Programit të Akteve Rregullatore. • Z. Eris Cela - Koordinator, Njësia e Programit të Akteve Rregullatore. • Znj. Ardena Torollari - Koordinator, Njësia e Programit të Akteve Rregullatore.
Date	23.02.2023
Takim konsultativ Forma të tjera	1 E-mail

konsultimi:	
I. Objektivi i konsultimit	
Qëllimi i zhvillimit të konsultimit:	<p>Detaje:</p> <p>Në kuadër të inicimit të hartimit të planit të ri të veprimit për OGP 2022 – 2024, u zhvillua takimi i konsultativ me palët e interesit të cilët kanë ekspertizë në fushën e konsultimit publik, koordinimit dhe dialogut të zhvillimit të politikave, demokracisë dhe transparencës.</p> <p>Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë prezantoi një angazhim i cili kontribuon në përmbushjen e parimeve themelore të OGP sic janë qeverisja demokratike, transparente dhe e përgjegjshme.</p> <p>Në takim morën pjesë 6 përfaqësues nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - IDM Albania - Komiteti Shqiptar i Helsinkit - Këshilli i Investimeve
	- Ekspertë i pavarur
	Të ftuar për dhënie mendimi ishin dhe përfaqësues të OSCE me të cilët kryeministria ka bashkëpunuar për promovimin e procesit të konsultimit publik.
(i) Prezantimi i palëve me angazhimin	<p><input type="checkbox"/>Jo / <input checked="" type="checkbox"/>Po</p> <p>Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë në kuadër të detyrimeve që burojnë nga anëtarësimi i Shqipërisë në Partneritetin për Qeverisjen e Hapur, ka propozuar angazhimin si më poshtë:</p> <p>Vlerësimi i ndikimit rregullator, programimi i akteve rregulatore dhe konsultimi publik të janë në themel të një sistemi politikë-bërje të bazuar në të dhëna, të mirë planifikuar dhe që mundëson përfshirjen e publikut në vendimmarrje, për një qeverisje demokratike, transparente dhe llogaridhënëse.</p>
(ii) Prezantimi i palëve me procesin	<p><input type="checkbox"/>Jo / <input checked="" type="checkbox"/>Po</p> <p>Në takimin konsultativ, i cili u mbajt online në Platformën Microsoft Teams me aktorë të interesuar, të cilëve iu dha mundësia të ofrojnë opinionet dhe sugjerimet e tyre, lidhur mbi propozimin e masave/produkteve konkrete lidhur me angazhimin, u sjegua ecuria e procesit dhe rëndësia e bashkë-krijimit të masave të ndërmarra.</p>

(iii) Mënyrat e kthimit të përgjigjeve	<input type="checkbox"/> Jo / <input checked="" type="checkbox"/> Po Në takim u dakordësua mbi materialet që do dërgohen pas mbledhjes, afatet dhe mënyrat për dërgimin e komenteve dhe propozimeve.
(iv) Propozimet e mbledhura nga procesi	<input type="checkbox"/> Jo / <input checked="" type="checkbox"/> Po Pjesmarrësit dërguan me email propozimet e tyre dhe komentet jo vetem lidhur me masat por dhe me përmbajtjen e dokumentit në seksione të tjera të tij. Të gjitha propozimet e dërguara janë marrë në konsideratë dhe janë përfshirë në draftin final të fishës së angazhimit.

Rekomandime të mbledhura:

- Zhvillimi i workshop-eve lidhur me informimin dhe trajnimin e organizatave të biznesit lidhur me procesin e konsultimit publik;
- Shtimi i një mase prioritare të re e cila lidhet me trajnimin e administratës publike në bashkëpunim me IDM.
- Vendosjen e shifrave konkrete të progresit për proceset e KP dhe VNR bazuar në raportet e vlerësimit të SIGMA-s.
- Zëvendësimi i termave.
- Vendosja e referencës lidhur me raportet e SIGMA dhe OGP
- Qasje proaktive dhe në shmangie të barrierave
- Qeverisje llogaridhënëse, si dhe politika jo diskriminuese dhe gjithëpërfshirëse;
- Publikimi rigoroz dhe sipas parashikimeve ligjore në ligjin nr.146/2014 të raporteve të transparencës në procesin vendimmarës
- Garantimi i qëndrueshmërisë së koordinatorëve për njoftimin dhe konsultimin publik në secilin institucion përgjegjës dhe ky pozicion të ushtrohet nga nëpunës civilë të nivelit të mesëm ose të lartë drejtues, për të garantuar autoritetin e nevojshëm në të gjitha nivelet e punonjësve dhe strukturat e institucioneve për zbatimin e ligjit nr.146/2014.
- Monitorimi i zbatimit të përmbushjes së detyrimit nga institucionet për të përditësuar në mënyrë periodike raportet e konsultimit publik të hartuara, në kuadër të zbatimit të detyrave të tyre funksionale kundrejt publikut të gjerë.
- Institucionet përgjegjëse kontribuojnë në hartimin e qasjeve metodologjike dhe formateve të thjeshta e të kuptueshme për publikun e gjerë dhe palët e interesit, të cilët synojnë përfshirjen në procesin e konsultimit publik.
- Nxitje e një qasjeje monitoruese dhe vlerësuese nga ana e institucioneve eprore, ndaj atyre të varësisë, lidhur me zhvillimin e indikatorëve krahasimorë dhe analizues, të suksesit, vështirësive e sfidave me të cilat haset procesi i njoftimit dhe konsultimit publik.

